



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 36253
Nr. llog. 05 Data 30/12/2025
Br. sh. 28867
KAMENICE - KAMENICA
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Referencë:	
Për/Za/To:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës
CC:	
Përmes/Preko/Throgh:	
Tema/Subjekat/ Subjeket:	Raporti për Takimin Publik lidhur me gjashtë mujorin e dytë të punës së Ekzekutivit për vitin 2025

Raporti është përgatitur duke u bazuar në UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË.

Më datë 22.12.2025 është publikuar njoftimi për organizimin e takimit të dytë publik me qytetarë i Kryetarit Kadri Rahimaj për punën gjashtë (6) mujore të dytë të vitit 2025.

Organizimi i takimit është bërë nga kryetari-kabineti i kryetarit dhe zyra për informim.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në Facebook:

Më datë 01.12.2025 është publikuar njoftimi për organizimin e këtij Takimi Publik që do të mbahej. Njoftimi është publikuar në Web-faqen e Komunës dhe në Facebookun e Komunës.

-Publikimet në uebfaqe:

Shqip/Serbisht: <https://kamenice.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/32960.pdf>

-Publikimet në Facebook:

Shqip/Serbisht:

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid0327F9dZZcrJaoTQs4rJ3UZNmxAFJK6URVRCw9rkQowuHU5FVib2B96N2YxmBT7eI>

Ndërsa më datën 22.12.2025 duke filluar nga ora 15:00 shtë mbajtur Takimi Publik, ku është paraqitur para të pranishmëve puna e ekzekutivit për gjashtëmujorin e dytë të punës për vitin 2025, dhe të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, qytetarë dhe të tjerë.

Të pranishëm kanë qenë Kryetari Kadri Rahimaj, Kabineti i Kryetarit përfshirë Drejtorët e Drejtorive, Zyrtarë Komunal, OJQ.

Hapja e takimit është bërë nga Kryetari Rahimaj, i cila ka falënderuar të pranishmit duke thënë se tani po paraqitet puna e gjashtëmujorit të dytë të Ekzekutivit për vitin 2025.

Kryetari Kadri Rahimaj:

Punët në këtë 6 muor i kemi ndarë në këto sektore:

Projekte të realizuara në arsim, infrastrukturë rrugore, shëndetësi, kulturë e zhvillim u paraqiten në detaje.

Kryetari Rahimaj:

Në fushën e arsimit janë realizuar punë tejet të rëndësishme si: është hapur drejtimi i ri – kulinari, 154 përfitues të bursës komunale këtë vit, të gjitha shkollat me kamera sigurie dhe sistem vijushmërie, është ndërtuar çerdhja e re në Koretin, mjete të reja didaktike dhe lodra për fëmijë në çerdhe, poashtu janë duke u bërë përgatitjet e fundit për mësimin tërëditor.

Në fushën e infrastrukturës, disa nga projektet kryesore janë sinjalistika në qytet, është zgjeruar dhe asfaltuar rruga kryesore në qytet si dhe është pajisur me ndriçim e trotuar, janë përfunduar edhe 11 rrugë lokale në Hogosht, 8 rrugë të tjera të asfaltuara për Karaçevën e Poshtme, 11 rrugë të asfaltuara në Karaçevën e Epërme, asfaltimi i dy rrugëve të tjera në Koretin, është rregulluar trotuari në Kopërnice e rrjeti i ndriçimit public, janë asfaltuar 10 rrugë në Muçiverc, dy rrugë në Dajkoc, asfaltimi rrugës “Tema” në Busavatë, asfaltimi i 12

rrugëve në Roganë, rregullimi i parkingut të AMF-së në Roganë, është shtruar shtresa e dytë e asfaltit tek rrugët në Feriçevë, Lumi në Kopernicë do të kthehet në atraksion për qytetarë ku në një projekt për këtë janë paraparë shtigje për ecje, hapësira rekreacioni, fushë streetballi, parking për vetura, parking për biçikleta, është rregulluar parkingu i shkollës “Dëshmorët e Kombit”, do të rinovohet stadium i qytetit, do të bëhet asfaltimi i rrugëve në Krilevë, poashtu në process është asfaltimi i 17 rrugëve në Topanicë, ndër të tjera në proces është edhe asfaltimi i rrugëve në lagjen “Malësia” në qytet.

Ndërsa në fushën e Shëndetësisë QKMF është furnizuar me autoambulancë e re.

Sa i përket Zhvillimit Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit ka dhënë opinion të pamodifikuar për pasqyrat financiare, ndër të tjera janë ndarë pakot babybox për përfituesit e rinj, një ditë i është kushtuar diasporës, Kamenica është përzgjedhur për shpërbardje e internetit publik falas, është arritur marrëveshja për hartimin e planit të mobilitetit, është organizuar festivali Kamenica Summer Fest, 19 praktikantë me pagesë janë angazhuar në Komunën e Kamenicës, Kamenica është bërë pjesë e rrjetit botëror ‘Mayors for Peace’, projekti për ndërtimin e Parkut të Aventurave tek Lugu i Verdhë, është nënshkruar marrëveshja për dhënien në shfrytëzim të vendgjahishtës, është ndërtuar kuzhina popullore në shërbim të nxënësve dhe rasteve në nevojë.


E në fushën e Kulturës, janë realizuar disa aktivitete si mbajtja e konferencës shkencore ‘Kamenica në rrjedha të historisë’, dhe për herë të parë është mbajtur dita e nderit në Kamenicë.

Ndërsa këtë takim po e mbylli duke iu treguar se për vitin 2026 Kamenica do të ketë buxhetin më të madh në histori me gjithësej 15,606,103 Euro, ku sipas tij prej tyre 2 milionë Euro janë të dedikuara për investime kapitale.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet/P yetje	Njoftimi
Diskutim publik për gjashtëmujo rin e dytë të 2025-ës për punën e Ekzekutivit	Zyra e Kryetarit	18 pjesëmarrës	Salla e Kuvendit Komunal	Nuk ka	-Publikimet në uebfaqe: Shqip/Serbisht: https://kamenice.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/32960.pdf -Publikimet në Facebook: Shqip/Serbisht: https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid0327F9dZZcrJaoTQ5s4rJ3UZNmxAfJK6URVRCw9rkQowuHU5FVib2B96N2YxmBTr7eI

Zyrtare për Diskutime Publike:

Valdete Berisha-Murina





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes në Takimin Publik për gjashtë-mujorin e dytë të punës së Kryetarit për vitin 2025

Data: 22.12.2025

Ora: 15:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1.	Hysein Kripaon	Reyne	Kripaon
2.	Arbinte Sejdiu	DAP	Sejdiu
3.	Diana Ajva	DPGJK	Ajva
4.	Glusën Gjeslën	DSHPAIE	Gjeslën
5.	ZOTIRI KASTRATI	SHPAI-E	Kastrati
6.	SAMI MORINA	DSHPAI	Morina
7.	SHKUR LUTAJI	DSHPAIG	Lutaj
8.	MURIM KROMSI	DSHPAI	Kromsi
9.	ALBAN MALIQI	KAMENICË	Maliqi
10.	Milaim LIMONI	Kamenicë	Limoni
11.	Lulzim ZEMRI	KAMENICË	Zemri
12.	IBRAHIM KASTRATI	KAMENICË	Kastrati
13.	ENVER ISMAJLI	KAMENICË	Ismajli
14.	Dielza Këhancaj	Kamenicë	Këhancaj
15.	ISMET AHMETI	KAMENICE	Ahmeti
16.	HASAN KEÇUTI	Kamenicë	Keçuti
17.	SELAMI ZYLFIU	Kamenicë	Zylfiu
18.	Amir Jashari	Kamenicë	Jashari
19.			
20.			

PREZANTIMI I PUNËVE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2025

The background of the image is a solid blue color with a faint, light blue pattern of overlapping circles and lines, resembling a stylized map or network. In the center, there is a white rounded rectangle containing the text 'Arsim' in a bold, dark blue font.

Arsim



Drejtimi i ri - **KULINARI**

Në IAAP “ANDREA DURRSAKU”
tashmë është edhe drejtimi i
kulinarisë.

Ky drejtim ka **9** nxënësit e parë.





154 PËRFITUES të bursës komunale këtë vit

Gjithsej 154 përfitues e prej tyre
101 vajza dhe **53 djem.**
Një buxhet i ndarë prej 53,400 € për
studentët.





Të gjitha shkollat me kamera sigurie dhe sistem vijushmërie

Për sigurinë e nxënësve tanë!





MË TË MIRËT, JANË SHPËRBLYER!

Komuna ka vazhduar të qëndrojë afër çdo nxënësi të dalluar dhe çdo mësimitdhënësi të përkushtuar, sepse sukseset e tyre janë shtysë për të gjithë ne.

83 NXËNËS PËRFITUES
40 MËSIMDHËNËS PËRFITUES
45 EKIPE SPORTIVE

11,080€

73 NXËNËS (KLASA XI) - 7100€





ÇERDHIJA E RE NË KORETIN

Kapaciteti për **100 fëmijë**
Në bashkëpunim me
MASHTI -n

741,000 €





PËR NJË FILLIM TË MBARË TË VITIT TË RI SHKOLLOR NË KOMUNËN TONË

Në vlerë prej **11,890.90 €**, këtë vit kemi shpërndarë **23 artikuj** të ndryshëm me gjithsej **8,714** materiale dhe mjete didaktike për të gjitha shkollat e komunës sonë.





LODRA TË REJA PËR FËMIJË PËR TË GJITHA SHKOLLAT NË KAMENICË

Janë blerë lodra të reja për të gjithë
parashkollorët si dhe të vegjëlit në
çerdhe, në vlerë prej **9400 €**, me
standarde europiane dhe të
përshtatshme për ta.





Po bëhen përgatitjet e fundit për fillimin e mësimit tërëditor



Infrastrukturë



SINJALISTIKA në qytet

Shuma: 55,912 €



RRUGA KRYESORE NË QYTET U TRANSFORMUA DHE MORI PAMJE TË RE MODERNE

Zgjerim dhe asfaltim i rrugës
Shenjëzim
Ndriçim eficient, dhe
Trotuar i ri

Shuma: 284,72618 €



Janë përfunduar edhe 11 rrugë lokale në Hogosht

Rruga “Avdi Xhaqku” (degëzim)

Rruga “Nexhmedin Ahmeti”

Rruga “Martirët e Hogoshtit” (degëzimi 1)

Rruga “Taip Sermaxhaj”

Rruga “Isa Kastrati” (degëzim)

Rruga “Martirët e Hogoshtit” (degëzim)

Rruga “Shefki Latifi”

Rruga “Rexhep Malaj” (degëzimi 2)

Rruga “Lagjja e Batallëve”

Rruga “Martirët e Hogoshtit” (degëzimi 3)

Rruga “Rexhep Malaj” (degëzim) në proces

Në vlerë prej **228,893.92 €** janë përfunduar
së asfaltuari **1947.33 metra** infrastrukturë
rrugore.



Edhe 8 rrugë të tjera të asfaltuara për Karaçevën e Poshtme

Rruga “Fehmi Keka” (degëzim)

Rruga “Namazit” (degëzim)

Rruga “Molla Destani”

Rruga “Femi Keka” (degëzimi 1)

Rruga “Femi Keka” (degëzimi 2)

Rruga “Lah Keka”

Rruga “Asllan Thaqi” (degëzim)


Rruga “Asllan Thaqi” (degëzimi 1)

Janë asfaltuar edhe 1382 m gjatësi rrugore në Karaçevë të Poshtme në vlerë prej 90,481 €.



Edhe 11 rrugë të asfaltuara në Karaçevën e Epërme

Rruga “Pavarësia e Kosovës”,
Rruga “Ardhmëria e Kombit”,
Rruga “Selim Genga” (degëzim),
Rruga “Rruga e Kombit” (degëzim),
Rruga “Vija e gjelbër” (degëzim),
Rruga “Vija e gjelbër” (degëzim 1),
Rruga “Vija e gjelbër” (degëzim 2),
Rruga “Genga” (degëzim),
Rruga “Jakup Karaqeva”
Rruga “Dardha” (degëzim).
Rruga e Fitores në proces
Shuma: 88,555.03 €





Asfaltimi i dy rrugëve të tjera në Koretin

Rruga “Kallaba” 132m

Rruga “Ushtarët e UÇKsë” -degëzim 83 m

Shuma: 27,867.62 euro





Trotuari në Kopërnice e rrjeti i ndriçimit publik

Shuma: 90,698.86 euro





Rrugët në Muçivërc

Rruga "Ismaj Hashani" 13,988.94€

Rruga "Can Bojku" 17.237.85€

Rruga "Ban Boku" 11.966.07€

Rruga "Hasan Nuhë Spahiu Deg, I" 10.236.15€

Rruga "Rexhep Hashani" 14,152.16€

Rruga "Veteranet e Aisnt Degezmi 2" 2.458.10€

Rruga "Hoxhe Hasan Masurica Deg. I" 16.210.03€

Rruga "Hoxhe Hasan Masurica Deg.II" 8,536.40€

Rruga "Alush Spahiu Deg" 4,326.70€

Rruga "Hoxhe Hasan Masurica Deg. 3" 12.391.14€





Rrugët në Dajkoc

Rruga “Sylë Ramë Dajkovci” -
68,751.81 euro

Rruga “Sylë Ramë Dajkoci” -
degëzim 110,658.80€





Rruga “Tema” në Busavatë

225.18m

52,326.01€





Rrugët në Roganë

Rruga e Dijes deg.1 (L=64m) - 8637.10€

Rruga e Dijes deg.2 (L=19m) - 3271.86€

Rruga e Dijes deg.3 (L=88m) - 10507.60

Rruga "Haxhi Nuhiu" (L=118m) - 13291.00€

Rruga "Selver Kryeziu" (L=110m) - 7463.00€

Rruga "Selver Kryeziu" deg.2 (L=45.90m) - 4958.11€

Rruga "Selver Kryeziu" deg.3 (L=48.91m) - 5058.94€

Rruga "Selman Trena" deg.1 (L=24.10m) - 2288.69€

Rruga "Banimi i ri" deg.1 (L=138.60m) - 17935.92€

Rruga "Mergimtari" deg.1 (L=85.30m) - 10668.40€

Rruga "Mergimtari" deg.2 (L=89.45m) - 4244.15€

Rruga "Selver Kryeziu" deg.6 (L=75.72m) - 10067.98€





Parkingu i AMF-së në Roganë (L=40m)

7800€





RRUGËT NË FERIÇEVË

Shtresa e dytë e asfaltit

“Rruga e fushave” me gjatësi prej 914,16 m,

Rruga “Bejtë Pireva” me gjatësi prej 1846.25 m


Totali i investimit në këto dy rrugë kap shifrën e 860,387 €



LUMI NË KOPËRNICË DO TË KTHEHET NË ATRAKSION PËR QYTETARË

Shtigje për ecje,
Hapësira rekreacioni
Fushë streetballi,
Parking për vetura,
Parking për biçikleta.

Një projekt në vlerë prej
288,000 €






PARKINGU I SHKOLLËS

“Dëshmorët e Kombit” në
Kamenicë

Një lehtësi për prindërit e
personelin, më shumë siguri
për fëmijët si dhe pamje më e
bukur për shkollën e qytetit.

Shuma: 23,277.60 €





STADIUMI I QYTETIT DO TË RINOVOHET

Stadiumi i duhet qytetit e sportdashësve, por më së shumti, i duhet talentit dhe potencialit sportiv që kemi si Kamenicë.

Bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport





NË KRILEVË PO VAZHDOJMË ME INVESTIME KONKRETE që lehtësojnë jetën e çdo familjeje

Me 1,238,307.72 € investim po
asfaltohen rrugët lokale:

- Rruga Ahmeti
- Livagjet
- Rruga Mahmuti në Strezoc
- 16 degëzime brenda lagjeve të Krilevës



An aerial photograph of a road winding through a landscape, overlaid with brown topographic contour lines. The text is centered over the road. There are also some small square markers and a cross symbol on the map.

NË PROCES ËSHTË
ASFALTIMI I 17 RRUGËVE
NË TOPANICË

Shuma: 347,314,33 €

Në proces është asfaltimi i rrugëve në lagjen “Malësia” në qytet

5 RRUGË NË VLERË PREJ 171,720.73 €


Rruga “Nuhi Berisha”

Rruga “Beteja e Ushit”

Rruga “Rruga e Krojeve”

Rruga “Rruga e Krojeve”- degëzim

Rruga “Shpend Dragobia”.



The background of the slide is a solid blue color with a faint, light blue pattern of overlapping circles and lines, resembling a stylized map or network. In the center, there is a white rounded rectangle containing the text.

Shëndetësi



KAMENICA ME AUTOAMBULANCË TË RE!

Falë bashkëpunimit me
Ministrin Arben Vitia,
Kamenica po ecën përpara
me vepra, jo fjalë.



The background of the image is a solid blue color with a faint, light blue pattern of overlapping circles and lines, resembling a stylized map or network. In the center, there is a white rounded rectangle containing the word "Zhvillim" in a bold, dark blue sans-serif font.

Zhvillim



I PAMODIFIKUAR PËR PASQYRAT FINANCIARE

Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit

Që qeverisja ka ecur në rrugën e transparencës dhe qeverisjes së mirë, e kjo është dëshmuar edhe me raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, me ç'rast Komuna e Kamenicës ka pranuar raportin më të mirë ndonjëherë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlera Spanca,
Auditor e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

1 Opinioni i Auditimit

Në kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Në i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës (KK), të cilat përbëjnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmblendjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.


Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkuara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Kamenicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.



Kemi ndarë pakot BABYBOX për përfituesit e rinj





Diaspora OPEN DAY



INTERNET PUBLIK + Falas



#GrowthPlan

Implemented by





E KEMI MARRRËVESHJEN PËR HARTIMIN E PLANIT TË MOBILITETIT

Plani i mobilitetit është një dokument strategjik i nevojshëm e me rëndësi për komunën, që lehtëson dhe përmirëson levizjet urbane dhe jo vetëm.

Bashkëpunim me FES dhe UN Habitat





Kamenica si
asnjëherë më parë
në ditët e verës





EDHE 19 PRAKTIKANTË ME PAGESE NË KOMUNËN E KAMENICËS

E pesta thirrje me radhë

Bashkëpunim me **Generation Unlimited**



JEMI BËRË PJESË E RRJETIT BOTËROR

Mayors for Peace!

Kjo organizatë globale, me mbi 8,400 qytete anëtare nga 166 shtete dhe rajone, ka për mision ndërtimin e një bote pa armë bërthamore, forcimin e solidaritetit ndërqytetas dhe promovimin e paqes e zhvillimit të qëndrueshëm.

Anëtarësimi i Kamenicës është një hap i madh që na vendos në hartën e qyteteve paqedashëse të botës.





PARKU I AVENTURAVE

tek Lugu i Verdhë

Shuma: 299,487.00 €





EDHE NJË MARRËVESHJE E MIRË ME NDËRMARRJEN PUBLIKE “DARDANA”

Kemi nënshkruar marrëveshjen
për **dhënien në shfrytëzim të
vendgjahishtes.**





Kuzhina popullore në shërbim të nxënësve dhe rasteve në nevojë

Në bashkëpunim me shoqatën
“Jetimat e Ballkanit”

520,731.01€





VIZITA NË ZVICËR

Vizitë në Parlamentin e
Cyrihut

Turniri nga shoqata
humanitare “Koretini”



The background of the slide is a solid blue color with a faint, light blue pattern of overlapping circles and lines, resembling a stylized map or network. A large, white, rounded rectangular shape is centered on the slide, containing the word "Kulturë" in a bold, dark blue font.

Kulturë



“KAMENICA NË RRJEDHA TË HISTORISË”

Punime shkencore të dala nga Konferenca Kombëtare “Kamenica në rrjedha të historisë” në Kamenicë, të gjitha të bëra bashkë në këtë dokument, iniciativë totalisht e nisur nga komuna.





PËR HERË TË PARË ËSHTË MBAJTUR DITA E NDERIT NË KAMENICË

Për herë të parë Komuna e Kamenicës, ka nderuar personalitetet që me punën e tyre kanë kontribuar në historikun dhe zhvillimin e komunës sonë.





PËR 2026

15,606,103 €

Buxheti më i madh në histori të Kamenicës

2 MILIONË EURO

janë të dedikuara për investime kapitale.



Me besimin që më keni
dhënë, kam dhënë
betimin si Kryetar
Komune edhe për një
mandat



Faleminderit për Vëmendjen!

